



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 685/24

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Isa Hasani - kryetar, Kimete Gashi dhe Vedat Poterqoi - anëtar, pas shqyrtimit të Kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Komuna Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), (Nr.Protokolli 685/23), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik Valmir Mustafa B.I, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Bartja e të moshuarve dhe funksionalizimi i shtëpisë për të moshuar, Lot 1 - bartja e të moshuarve në relacionin Rahovec – shtëpia për të moshuar dhe anasjelltas, me nr: te prokurimit: 623-24-1910-2-2-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, me 30.01.2025, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet, si e bazuar kërkesa e Komunës së Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 02.08.2024, kurse OE Valmir Mustafa B.I, me nr. unik: 810097528 – Prizren, diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 3 (tre) muaj, duke filluar nga data 31.01.2025 deri me datën, 30.04.2025, për shkak se i njëjti e ka mashtruar AK-Komunen e Rahovecit.

A R S Y E T I M

Kërkesa e AK- Komuna Rahovecit:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se OE Valmir Mustafa B.I, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Bartja e të moshuarve dhe funksionalizimi i shtëpisë për të moshuar, Lot 1 - bartja e të moshuarve në relacionin Rahovec – shtëpia për të moshuar dhe anasjelltas, me nr: te prokurimit: 623-24-1910-2-2-1, ka mashtruar me arsyetimin se pas përfundimit të vlerësimit të ofertave e kemi rekomanduar për kontrate dhe kemi vazhduar proceduralisht me nënshkrim të kontratës ku edhe pas disa ftesave të bëra, OE Valmir Mustafa B.I, nuk është paraqitur për nënshkrim të kontratës.

AK-ja, ne kërkesën e parashtruar për marrjen me masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, i ka bashkangjitur edhe email-a, përmes të cilave e ka ftuar OE Valmir Mustafa B.I, për nënshkrim të kontratës.

OE Valmir Mustafa B.I, e ka konfirmuar përmes email-it se me datën: 30.05.2024, do të paraqitet pran zyrës së prokurimit në Komunën e Rahovecit dhe i njëjti është deklaruar se do të nënshkruaj kontratën.

Duke u bazuar në sqarimin e dhënë më lartë, AK-ja pretendon se OE Valmir Mustafa B.I, ka mashtruar AK-ne, duke deklaruar se, do të nënshkruaj dhe më pas nuk është paraqitur për nënshkrim të kontratës, andaj kërkon marrjen e masave ndaj operatorit ekonomik, sipas nenit 99.2 të LPP-se.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të pranuar kërkesën e datës: 02.08.2024 të AK - Komuna Rahovecit, e ka njoftuar OE Valmir Mustafa B.I, me qëllim që operatori ekonomik në fjalë të jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

Operatori ekonomik Valmir Mustafa B.I, nuk është përgjigjur në kërkesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Vlerësimi i pretendimeve të autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj Valmir Mustafa B.I:

Paneli shqyrtues, bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe provat e administruara, ka konstatuar se qëndrojnë pohimet e AK-se, sikurse janë përshkruar ato në kërkesën e datës: 02.08.2024, sepse OE Valmir Mustafa B.I, nuk është paraqitur për nënshkrim të kontratës.

Paneli shqyrtues, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga autoriteti kontraktues, vlerëson se AK-ja, ka dorëzuar prova të mjaftueshme për marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se.

Në rastin konkret autoriteti kontraktues ka dorëzuar korrespondencat me OE Valmir Mustafa B.I, i cili në email-in e datës: 30.05.2024, ka deklaruar se do të paraqitem pran AK-se, për nënshkrim të kontratës dhe i njëjti nuk e ka vazhduar me nënshkrim të kontratës. OSHP, mbi bazën e provave të prezantuara vlerëson se OE Valmir Mustafa B.I, e ka mashtruar AK-ne, sepse i njëjti nuk është paraqitur për nënshkrim të kontratës dhe për më tepër nuk ka kthyer asnjë përgjigje në OSHP, për të dhënë faktet dhe argumentet e tija.

Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të marr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, ka dorëzuar prova të mjaftueshme se OE Valmir Mustafa B.I, ka mashtruar përmes email-it dhe ky veprim të kualifikohet si mashtrim nga ana e OE ankues.

Paneli shqyrtues, vlerëson se janë plotësuar kushtet për zbatim të nenit 99 paragrafit 2 të LPP-se, për marrjen e masave eventuale sipas nenit të cituar më lart, sepse veprimet e operatorit ekonomik pas dorëzimit të ofertave sanksionohen me dispozitat e nënve të përmendura më lart.

Andaj, paneli shqyrtues vendos që OE Valmir Mustafa B.I, të vendoset në listën e zezë në kohëzgjatje prej tre (3) muajve.

Duke ju referuar të lartcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 99.2 të LPP, Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari Panelit
Isa Hasan



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë që të drejtohet me kërkesëpadi Gjykatës Kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Rahovecit

1x1 OE Valmir Mustafa B.I.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së